



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. ____/2026

PËR

**DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 111/2017 “PËR
NDIHMËN JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI”¹**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, 81, pika 2, shkronja “d”² dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

Në ligjin Nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

¹ Ky Ligj është përafshuar me:

- Direktivën (BE) 2012/29 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 25 tetor 2012, që përcakton standardet minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, dhe që zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA.
- Direktivën (BE) 2016/1919 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 26 tetorit 2016, mbi ndihmën juridike për të dyshuarit dhe të akuzuarit në procedurat penale dhe për personat e kërkuar në procedurat e urdhër-arresteve evropiane, numri CELEX 32016L191, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 297/1, datë 4.11.2016.
- Direktivën (BE) 2017/541 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 15 marsit 2017, për luftën kundër terrorizmit dhe zëvendësimin e Vendimit Kornizë të Këshillit 2002/475/JHA dhe ndryshimin e Vendimit të Këshillit 2005/671/JHA, numri CELEX 32017L0541, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 88/6, datë 31.3.2017.
- Direktivën (BE) 2019/1937 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e 23 tetorit 2019, mbi mbrojtjen e personave që raportojnë shkelje të ligjit të Bashkimit, numri CELEX 32019L1937, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 305/17, datë 26.11.2019.

² Miratimi i ligjit kërkon shumicë të cilësuar për nenet 12, 13 dhe 15.

Neni 1

Në nenin 2, pas shkronjës “c”, shtohet shkronja “ç” me përmbajtjen si më poshtë:

“ç) të kontribuojë, nëpërmjet shërbimit të ndihmës juridike, në informimin, edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë.”

Neni 2

Në nenin 3, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Pas shkronjës “j”, shtohet shkronja “j/1”, me përmbajtjen si më poshtë:

“j/1) “Shpenzime kadastrale dhe noteriale”, janë shpenzimet e nevojshme për të përfituar ndihmë juridike dytësore në kuadër të procesit gjyqësor, për vendosjen në ekzekutim, si edhe ekzekutimin e titullit ekzekutiv.”

2. Pas shkronjës “k”, shtohen shkronjat “l”, dhe “ll” me përmbajtjen si më poshtë:

“l) “Tarifa të tjera të domosdoshme gjatë procesit të ekzekutimit të vendimit”, janë tarifat për ekspertë, si dhe tarifa të tjera që paguhën gjatë ekzekutimit të vendimit, të cilat janë të detyrueshme sipas legjislacionit në fuqi.

ll) “Viktimë krimi”, është:

i) personi fizik që ka pësuar dëm, përfshirë dëmin fizik, mendor ose emocional, ose humbje ekonomike, të shkaktuar drejtpërdrejt nga një vepër penale;

ii) familjarët e personit deri në shkallë të parë, vdekja e të cilit është shkaktuar drejtpërdrejt nga një vepër penale, kur këta familjarë kanë pësuar dëm si pasojë e vdekjes së tij.”

Neni 3

Në nenin 5, pas shkronjës “c”, shtohet shkronja “ç”, me përmbajtjen si më poshtë:

“ç) përjashtim nga pagimi i tarifave të tjera të domosdoshme gjatë procesit të ekzekutimit të vendimit, në rastet kur prania e ekspertit është e detyrueshme sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.”

Neni 4

Në nenin 6, pas shkronjës “ç”, shtohet shkronja “d”, me përmbajtjen si më poshtë:

“d) Njësitë e vetëqeverisjes vendore.”

Neni 5

Në nenin 7, pas shkronjës “j”, shtohet shkronja “k”, me përmbajtjen si më poshtë:

“k) miraton procedurat që ndiqen nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit në lidhje me pagesat e shpenzimeve për ekspertët, ekspertiza e të cilëve është e detyrueshme sipas parashikimeve të legjislacionit procedural në fuqi.”

Neni 6

Në nenin 8, behën shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 2, shkronja “d”, ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë:

“d) mbledh dhe analizon informacionin mbi dhënien e ndihmës juridike për të përmirësuar funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike.”

2. Në pikën 2, pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “d/1”, me përmbajtjen si më poshtë:

“d/1) Informon dhe ndërgjegjëson publikun dhe subjektet përfituese mbi të drejtën për ndihmë juridike, si dhe kontribuon në edukimin ligjor të publikut dhe rritjen e njohurive mbi të drejtat dhe sistemin e drejtësisë, përmes hartimit dhe shpërndarjes së materialeve informuese, fushatave ndërgjegjësuere në media dhe aktiviteteve në komunitet.”

3. Në pikën 2, shkronja “g”, togfjalëshi “për miratimin”, zëvendësohet me togfjalëshin “për hartimin dhe miratimin”.

4. Në pikën 2, shkronja “l”, përpara fjalës “zbaton”, shtohet togfjalëshi “administron dhe”.

Neni 7

Në nenin 9, shkronja “d”, ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë:

“d) përgatit dhe organizon programet e trajnimit të vazhdueshëm për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas. Aktiviteteve trajnuese dhe temat përkatëse sipas fushave të së drejtës të përfituesve të posaçëm sipas këtij ligji, miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.”

Neni 8

Pas nenit 9, shtohet neni 9/1, me përmbajtjen si më poshtë:

“Neni 9/1

Detyrat e njësive të vetëqeverisjes vendore

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me kompetencat e tyre, kontribuojnë në funksionimin e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti në mbështetje të ofruesve të ndihmës juridike parësore duke:

- a) informuar publikun mbi të drejtën për përfitimin e ndihmës juridike dhe shërbimet e disponueshme në njësitë përkatëse;
- b) vendosur në dispozicion, brenda fushës tyre së përgjegjësisë dokumentacionin e nevojshëm për përfitimin e ndihmës juridike;
- c) bashkërenduar punën ndërmjet shërbimeve sociale dhe institucioneve përgjegjëse për ndihmën juridike, me qëllim mbështetjen e përfituesve të ndihmës juridike sipas dispozitave të këtij ligji.”

Neni 9

Në nenin 11, behën shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Shkronja “a”, ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë:

“a) viktimave të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës të parashikuara në legjislacionin civil dhe penal për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje.”

2. Pas shkronjës “a”, shtohen shkronjat “a/1”, dhe “a/2”, me përmbajtjen si më poshtë:

“a/1) viktimave të krimit dhe familjarëve të tyre, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.”

“a/2) viktimave të terrorizmit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.”

3. Pas shkronjës “dh”, shtohet shkronja “dh/1”, me përmbajtjen si më poshtë:

“dh/1) personave që nuk përfitojnë pagesë për aftësinë e kufizuar dhe që kërkojnë njohjen e statusit të aftësisë së kufizuar, në lidhje me proceset ligjore që kanë për objekt përfitimin e këtij statusi.”

4. Shkronja “gj”, ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë:

“gj) personave të cilët janë përfitues të ndihmës ekonomike, pensionit social dhe skemave të tjera të mbrojtjes sociale sipas legjislacionit në fuqi.”

5. Pas shkronjës “h”, shtohen shkronjat “i” dhe “j”, me përmbajtjen si më poshtë:

“i) personave të komunitetit rom dhe egjiptian për sigurimin, plotësimin ose korrigjimin e dokumentacionit civil, regjistrimin civil, si dhe procedura të tjera të lidhura drejtpërdrejt me identifikimin dhe statusin juridik të personit.

j) personave që raportojnë ose bëjnë publik informacion mbi shkelje të së drejtës së Bashkimit Evropian në fushat e rregulluara nga legjislacioni përkatës i Bashkimit Evropian, në lidhje me proceset ligjore që burojnë drejtpërdrejt nga raportimi ose bërja publike e informacionit.”

Neni 10

Në nenin 17, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 1, ndryshohet si më poshtë:

“1. Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike parësore bëhet nga personi i interesuar dhe i drejtohet ofruesve të ndihmës juridike parësore.”

2. Pika 2, ndryshohet si më poshtë:

“2. Personi, i cili kërkon të përfitojë ndihmën juridike parësore, sipas pikës 1 të këtij neni, nënshkruan një vetëdeklarim se përmbush kriteret e përcaktuara në këtë ligj, sipas formularit të miratuar nga ministri i Drejtësisë, të shoqëruar me dokument identifikimi. Dokumentacioni justifikues kërkohet vetëm në rastet kur ekzistojnë dyshime të arsyeshme mbi vërtetësinë e vetëdeklarimit.”

3. Pika 5, ndryshohet si më poshtë:

“5. Në rast se gjatë dhënies së shërbimeve të ndihmës juridike parësore konstatohet konflikt interesi, ofruesi i shërbimit të ndihmës juridike parësore merr masat e nevojshme për shmangien e konfliktit të interesit dhe garantimin e vijimësisë së shërbimit për kërkuesin, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

4. Pika 7, ndryshohet si më poshtë:

“7. Gjatë ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore mbahet një procesverbal, i cili përmban:

a) emrin, mbiemrin, numrin e identifikimit personal dhe të dhënat e kontaktit të kërkuesit;

b) një përshkrim të shkurtër të problematikës ose çështjes për të cilën kërkohet ndihma juridike parësore;

c) kur është e mundur, kohëzgjatjen e takimit ose takimeve;

ç) një përshkrim të shkurtër të shërbimit të ofruar dhe rezultatit të tij;

d) vetëdeklarimin e kërkuesit sipas pikës 2 të këtij neni.”

Neni 11

Në nenin 19, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 1, pas togfjalëshit “në çdo fazë të procesit gjyqësor”, shtohet togfjalëshi “si dhe për çështje të ndërlidhura ndërmjet të njëjtave palë”.

2. Në pikën 2, pas togfjalëshit “ose një të afërmi të shkallës së parë”, shtohen togfjalëshi “si dhe nga subjektet e autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për subjektet përfituese sipas këtij ligji”.

3. Pas pikës 2, shtohet pika 2/1 me përmbajtjen si më poshtë:

“2/1. Për subjektet përfituese sipas këtij ligji ndihma juridike dytësore sigurohet, sa të jetë e mundur, nga i njëjti avokat gjatë fazave paraprake dhe procesit gjyqësor, përfshirë çështjet civile, penale dhe administrative të ndërlidhura që shqyrtohen ndërmjet të njëjtave palë.”

4. Pika 5, ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë:

“5. Subjektet përfituese nënshkruajnë një vetëdeklarim sipas formularit të miratuar nga ministri i Drejtësisë dhe sipas rastit, paraqesin dokumentacionin që

vërteton statusin e tyre si kategori përfituese. Lista e dokumenteve përcaktohet me urdhër të ministrit të Drejtësisë.”

Neni 12

Në nenin 20, pas pikës 2 shtohen pikat 3 dhe 4, me përmbajtjen si më poshtë:

“3. Në rastet e kërkesave për urdhër mbrojtjeje dhe urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, si dhe në çështjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të të miturve, kërkesa për ndihmë juridike dytësore shqyrtohet me procedurë të përshpejtuar.”

4. Me regjistrimin e kërkesës, gjyqtari i caktuar për shqyrtimin e çështjes vendos menjëherë për caktimin e avokatit nga listat e avokatëve të miratuar për ofrimin e ndihmës juridike dytësore, të trajnuar sipas natyrës së çështjes, dhe urdhëron njoftimin pa vonesë të avokatit, Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe përfituesit, duke u vënë në dispozicion edhe aktet e nevojshme për përfaqësimin dhe mbrojtjen juridike.”

Neni 13

Pas nenit 21, shtohet neni 21/1, me përmbajtjen si më poshtë:

“Neni 21/1

Procedura e dhënies së ndihmës juridike dytësore për viktimat në procesin penal

1. Në rast se kërkesa për ndihmë juridike dytësore paraqitet sipas pikës 3 të nenit 20, të këtij ligji, organi procedues që fillon hetimet ose gjykata shqyrton menjëherë nëse përmbushen kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

2. Nëse organi procedues ose gjykata vlerëson se kriteret janë përmbushur, cakton menjëherë një avokat nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore dhe njofton menjëherë subjektin dhe avokatin e caktuar.

3. Ndihma juridike dytësore për subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni sigurohet, sa të jetë e mundur, nga i njëjti avokat në të gjitha fazat e hetimeve paraprake dhe procesit gjyqësor, përfshirë çështjet e ndërlidhura civile, penale dhe administrative që lidhen me të njëjtat fakte ose palë.

4. Vendimi për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore jepet i arsyetuar dhe i njoftohet kërkuarit, Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

5. Kundër vendimit për rrëzimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, kërkuari mund të ushtrojë mjetet e ankimit sipas rregullave të parashikuara nga legjislacionin procedural.”

Neni 14

Në nenin 22, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 3, pas fjalës “pamundësinë”, shtohet fjala “financiare”.

2. Pas pikës 3, shtohen pika 3/1 dhe 3/2, me përmbajtjen si më poshtë:

“3/1. Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe drejtoritë vendore të saj vendosin në dispozicion të gjykatës, në bazë të urdhrit të saj, aktet kadastrale të nevojshme për shqyrtimin e çështjeve të parashikuara në pikën 3 të këtij neni, pa pagesë për përfituesin e ndihmës juridike dytësore.

3/2. Dhoma vendore e noterisë vendos në dispozicion të gjykatës aktet noteriale të nevojshme për shqyrtimin e çështjeve të parashikuara në pikën 3 të këtij neni, sipas legjislacionit në fuqi për noterinë.”

3. Pika 9 ndryshohet si më poshtë:

“9. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka të drejtë të ushtrojë ankim ndaj vendimit të gjykatës për pranimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, kur vlerëson se vendimi është marrë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në këtë ligj ose kur kërkesa rezulton haptazi e pabazuar apo abuzive. Në këtë rast zbatohen afatet dhe rregullat për ankimin e vendimeve përfundimtare sipas legjislacionit procedural. Kundër vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.”

4. Pas pikës 9 shtohet pika 10 me këtë përmbajtje:

“10. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka të drejtë të kërkojë sqarimin, plotësimin ose ndreqjen e vendimit gjyqësor në pjesën që lidhet me shpenzimet gjyqësore dhe efektet financiare që mbulohen nga fondet publike të ndihmës juridike falas, sipas parashikimeve të legjislacionit procedural.”

Neni 15

Pas nenit 22, shtohet neni 22/1, me përmbajtjen si më poshtë:

“Neni 22/1

Procedura e përshpejtuar për dhënien e ndihmës juridike dytësore në rastet emergjente

“1. Për subjektet e përcaktuara në nenin 20, pika 3 të ligjit, ndihma juridike dytësore jepet sipas procedurës së përshpejtuar.”

2. Punonjësi i cilitdo institucioni ose struktura përgjegjëse pranë së cilës paraqitet ose referohet rasti, informon menjëherë personin për të drejtën për të përfituar ndihmë juridike falas.

3. Procedura e përshpejtuar fillon me paraqitjen në gjykatë të formularit të kërkesës për ndihmë juridike dytësore, i cili mund të plotësohet nga institucioni ose struktura përgjegjëse pranë së cilës identifikohet ose referohet rasti, ose nga vetë personi që kërkon përfitimin e ndihmës juridike.

4. Me regjistrimin e formularit, gjyqtari i caktuar për shqyrtimin e çështjes cakton menjëherë avokatin nga listat e avokatëve të miratuar për ofrimin e ndihmës juridike dytësore dhe urdhëron njoftimin pa vonesë të avokatit dhe përfituesit.

5. Vendimi përkatës i komunikohet menjëherë kërkuarit, si dhe i njoftohet avokatit të caktuar, Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe dhomës vendore të avokatisë. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim sipas dispozitave të legjislacionit procedural.

6. Avokati i caktuar fillon menjëherë ofrimin e shërbimeve juridike të nevojshme për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të përfituesit.

7. Një kopje e vendimit i dërgohet Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe dhomës vendore të avokatisë.

8. Forma dhe përmbajtja e formularit miratohen me udhëzim të ministrit të Drejtësisë.

9. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton formatin standard të vendimit për caktimin e avokatit në rastet e procedurës së përshpejtuar. ”

Neni 16

Në nenin 24, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 1, shkronja “ç”, ndryshohet si më poshtë:

“ç) janë të specializuar ose kanë ndjekur trajnime të posaçme në fusha të caktuara të së drejtës, kur kjo kërkohet nga natyra e çështjes ose nga kategoria e përfituesit, përfshirë përfaqësimin e të miturve, të viktimave dhe në raste të tjera të parashikuara me ligj.”

2. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me përmbajtjen si më poshtë:

“1/1. Dhoma Kombëtare e Avokatisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, si dhe organizatave dhe agjencive të akredituara për të ofruar trajnime, organizojnë ose mbështesin programe të trajnimit të vazhdueshëm dhe listat e specializuara të avokatëve për kategori të veçanta përfituesish dhe fusha specifike të së drejtës.”

3. Pika 2, ndryshohet si më poshtë:

“2. Në rast të pranimit të kërkesës për ndihmë juridike dytësore, veprohet sipas rregullave të mëposhtme:

a) personi të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore ka të drejtë të zgjedhë avokatin që do ta përfaqësojë nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas informon përfituesin për këtë të drejtë dhe i vë në dispozicion informacionin e nevojshëm për ushtrimin e saj, sipas procedurave të përcaktuara me akt nënligjor. Përfituesi ushtron të drejtën e zgjedhjes së avokatit vetëm një herë, me përjashtim të rasteve të parashikuara në shkronjën “b” të këtij neni.

b) Në rast se personi nuk ushtron të drejtën e zgjedhjes sipas procedurës së përcaktuar me akt nënligjor, avokati i zgjedhur nuk pranon të ofrojë shërbimin, ndodhet në pamundësi për ta ofruar atë, ose ekzistojnë shkaqe të tjera që pengojnë përfaqësimin, dhoma vendore e avokatisë cakton një avokat nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, sipas parimit të rotacionit;

c) dhoma vendore e avokatisë përcjell vendimin e gjykatës kompetente, së bashku me njoftimin për avokatin e zgjedhur nga përfituesi ose, sipas rastit, me vendimin e saj për caktimin e avokatit, avokatit përkatës, Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe personit të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore.”

d) Procedurat për informimin e përfituesit, mënyra e ushtrimit të së drejtës së zgjedhjes së avokatit, komunikimit ndërmjet Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, Dhomës Vendore të Avokatisë dhe përfituesit, si dhe afatet përkatëse,

përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë”.

4. Pika 5, ndryshohet si më poshtë:

“5. Avokati i caktuar zëvendësohet, me kërkesë të personit të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore, me një avokat tjetër nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, kur rrethanat konkrete e justifikojnë këtë zëvendësim. Rrethana të tilla përfshijnë, por nuk kufizohen në, konfliktin e interesit ndërmjet avokatit dhe përfituesit të ndihmës juridike dytësore, pamundësinë objektive për vijimin e përfaqësimit ose shkaqe të tjera të arsyeshme që cenojnë mbrojtjen efektive të përfituesit të cilat vlerësohen rast pas rasti nga organi kompetent.”

5. Pas pikës 5 shtohet pika 5/1 me përmbajtjen si më poshtë:

“5/1. Kur natyra e çështjes e kërkon, veçanërisht në rastet e dhunës ndaj grave, dhunës në familje, trafikimit ose në çështje të ndërlidhura civile dhe penale, sigurohet, për aq sa është e mundur, vijueshmëria e përfaqësimit të përfituesit nga i njëjti avokat në të gjitha fazat e procedurës.”

Neni 17

Në nenin 25, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Shkronja “b”, ndryshohet si më poshtë:

“b) pagimi i shpenzimeve gjyqësore (shpenzimet për dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit, për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend), sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural, si dhe tarifat kadastrale dhe noteriale sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit, shpenzimet përmbartimore dhe shpenzimet e tjera të domosdoshme që lidhen me fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.”

3. Pas shkronjës “c”, shtohet shkronja “ç”, me përmbajtjen si më poshtë:

“ç) pagesa e tarifave dhe shpenzimeve për aktet kadastrale, noteriale ose çdo tarife tjetër të domosdoshme gjatë procesit të ekzekutimit të vendimit, në rastet

kur prania e ekspertit është e detyrueshme sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.”

Neni 18

Neni 29, ndryshohet si më poshtë:

“Personat, të cilët përfitojnë ndihmë juridike dytësore sipas parashikimeve të këtij ligji, gëzojnë të drejtën për të mos parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit pranë shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror, si dhe përjashtohen nga pagimi i tarifave të tjera të domosdoshme gjatë procesit të ekzekutimit të vendimit, në rastet kur prania e ekspertit është e detyrueshme sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.”

Neni 19

Në nenin 31, bëhet ndryshimi si më poshtë:

1. Në pikën 3, shkronja “a”, ndryshohet si më poshtë:

“a) nuk e ka paraqitur kërkesëpadinë në gjykatë, pas kalimit të një afati gjashtëmuor nga data kur vendimi i gjykatës për pranimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore ka marrë formë të prerë.”

Neni 20

Në nenin 32, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 1, ndryshohet si më poshtë:

“1. Kur provohet se përfituesi i ndihmës juridike dytësore dhe/ose përjashtimit nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore ka përfituar nëpërmjet deklarimeve të rreme, dokumenteve të falsifikuara ose formave të tjera të abuzimit, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas i kërkon kthimin e shpenzimeve të kryera, duke përcaktuar shumën dhe afatin për përmbushjen vullnetare të detyrimit, por jo më shume se 5 vite nga momenti i njoftimit. Procedura, periodiciteti dhe rregullat e verifikimit të ndryshimit të rrethanave përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Drejtësisë.

2. Pika 3, ndryshohet si më poshtë:

“3. Në rast të mosekzekutimit vullnetar të detyrimit brenda afatit të caktuar, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas paraqet kërkesëpadi në gjykatë, sipas legjislacionit në fuqi.”

Neni 21
Aktet nënligjore

1. Ngarkohen ministri i Drejtësisë dhe kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojnë aktet nënligjore në zbatim të nenit 7 dhe nenit 16, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri i Drejtësisë që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5, 10, 11, 20 dhe të pikës 8 të nenit 22/1 të këtij ligji.

3. Ngarkohet Këshilli i Lartë Gjyqësor që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktin nënligjor në zbatim të pikës 9 të nenit 22/1 të këtij ligji.

Neni 22
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe i fillon efektet prej datës 1 Janar 2027.

K R Y E T A R I

NIKO PELESHI